

EFTALI QIRJAQI



7786/1 Prot.

29.10.2015

Adresa: Lagje "Qemal Stafa", Rr. "Studenti",

Shkodër, Albania

Tel +355 2 22 417 46

Cel. 06902079434, Cel 0692069434

e-mail: eliqirjaqi@yahoo.com

## RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

Për Auditimin Ligjor të Fondeve të Përfituara dhe Shpenzuara  
Për vitin kalendarik 2014

### PARTIA LËVIZJA PËR TË DREJTAT E NJERIUT



Shkodër më 29 Tetor 2015



## RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

### KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Bulevardi: "Dëshmoret e Kombit"  
Pallati i Kongreseve, Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin nr.969, dt.10.08.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe Kontratës të Shërbimit Nr.7706, dt.28.09.2015, Jam caktuar për të audituar pasqyrat që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2014 nga "Partia Lëvizja për të Drejtat e Njeriut".

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të Partisë Lëvizja për të Drejtat e Njeriut.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi kryhet në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit, referencë të vecantë me SNA 800.

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyshme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posacëm të miratuar si model, me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë çmoj se nuk kam mundur të siguroj evidencë mbi bazën e të cilës të jap opinionin tim të auditimit.

Në pamundësi të sigurimit të evidencës nga "Partia Lëvizja e të Drejtave të Njeriut", për financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2014, nuk mund të shpreh opinion. Bashkëlidhur dokumentacioni dhe korrespondenca për të bërë të mundur realizimin e misionit të ngarkuar nga Komisioni Qëndror i zgjedhjeve.

Eksperte Kontabël e Regjistruar

Shkodër më 29 Tetor 2015

Eftali QIRJAQI